



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT 2017-2024

FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK

Gusht 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

Përmbajtja

1. Hyrja	3
1.2. Metodologjia e hartimit të planit të zhvillimit strategjik 2017-2024 për FSHP	3
2. Vizioni dhe Misioni i FSHP	4
3. Konteksti dhe situata aktuale në Fakultetin e Shëndetit Publik.....	5
3.1 Historiku	5
3.2 Logjistika	6
3.3 Burimet njerëzore	6
3.4 Burimet financiare	7
4. Analiza SWOT e Fakultetit të Shëndetit Publik.....	8
5. Prioritetet strategjike dhe Objektivat e zhvillimit	11
6. Plani i veprimit 2017-2024.....	16
7. Indikatorët e vlerësimit të performancës së strategjisë.....	23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK DEKANI

1. HYRJE

Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti 'Ismael Qemali' Vlorë synon të identifikohet si "Qendër e Zhvillimit Rajonal", me lidhje të forta me komunitetin lokal dhe me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të këtij komuniteti. Të jetë një fakultet me një rol aktiv në zhvillimin komunitar, shëndetësor e social, si dhe në shpërndarjen e njohurive në rajon.

Ky fakultet synon në vazhdimësi fuqizimin e sistemit kërkimor dhe inovativ në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të të mësuarit bazuar në evidenca, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve institucionale për çështjet e kujdesit shëndetësor, sigurisë ushqimore, shëndetit publik dhe mjedisit.

Strategjia afatgjatë e FSHP synon përmirësimin e rezultateve në shëndet për individët, familjen dhe komunitetin, nëpërmjet rritjes së kompetencave dhe aftësive, zhvillimit të vetëdijes kërkimore, si dhe kujdesit shëndetësor të bazuar në evidenca shkencore, duke e renditur kërkimin shkencor të kryer në fakultetin tonë në linjë me pritshmëritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

1.2 Metodologjia e hartimit të planit të zhvillimit strategjik 2017-2024 për Fakultetin e Shëndetit Publik

Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shëndetit Publik mbështetet gjerësisht në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020) Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipërinë (shtator 2015), kryesisht në OZHQ 3,4 dhe 16.

Prej një periudhe të gjatë disa mujore, ajo u konsultua në njësitë bazë të FSHP dhe me studentët e të dyja cikleve. Në funksion të përgatitjes së strategjisë së zhvillimit janë zhvilluar disa takime me anëtarët e njësisë bazë, në të cilat është diskutuar për veprimtarinë akademike, shërbimet në komunitet dhe kërkimin shkencor, përfshirë vendin e punës, studimet laboratorike, sintetizimin e të dhënave ekzistuese për zhvillimin e udhëzuesve dhe standarteve si dhe hartimin dhe implementimin e projekteve të ndryshme shkencore me fokus shëndetin publik.

Pas paraqitjes së nismës, dhe ngritjes së grupeve të punës filloi puna për hartimin e strategjisë bazuar në takimet e vazhdueshme me stafin akademik dhe studentët për të identifikuar se çfarë do të përfshihet në të.

Pas hartimit të drafteve nëpër njësitë bazë, strategjia e zhvillimit u diskutua me anëtarët e stafit akademik dhe draftet finale u dorëzuan në Dekanat. Plani Strategjik i Zhvillimit të Fakultetit të Shëndetit Publik u miratua me unanimitet nga të gjithë anëtarët e Dekanatit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

2. VIZIONI DHE MISIONI I FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK

2.1 Vizioni

Standart akademik ekselent: studentë të formuar profesionalisht për të qenë të gatshëm të integrohen në të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit. Fakulteti i Shëndetit Publik të funksionojë si qendër rajonale e promovimit të rritjes së standarteve të shërbimit shëndetësor në komunitet.

2.2 Misioni

Misioni madhor i Fakultetit të Shëndetit Publik është të rrisë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit. Qëllimi ynë konstant është të vazhdojmë të ofrojmë programe akademike infermierore me njohje dhe reputacion ndërkombëtar, në mënyrë që diplomat që ne ofrojmë të njihen nga tregu ndërkombëtar i punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

3. KONTEKSTI DHE SITUATA AKTUALE

3.1 Historiku

Fillimet e arsimit profesional infermieror në qytetin e Vlorës datojnë që në 1946 me çeljen e kursit 6-mujor për infermier me 10 djem nga Vlora dhe Fieri.

Në 1967 hapet shkolla e mesme mjekësore “Jani Minga”, që funksionoi si e tillë deri në vitin 1993. Më vonë mbi bazën e kësaj shkolle ngrihet Fakulteti i Infermierisë pranë Universitetit Teknologjik ‘Ismael Qemali’ në vitin 1994.

Për rreth 10 vjet nga ky fakultet janë formuar infermierë të përgjithshëm dhe infermier mami me programe profesionale 3,5 vjeçare. Në vitin akademik 2005-2006 u implementua për herë të parë sistemi i Bolonjës në kurrikulat e arsimit të lartë dhe që nga kjo periudhë e në vazhdim diplomat e ciklit të parë të studimeve që jep fakulteti ynë përfshijnë 6 semestra mësimorë (3 vite akademike) dhe mundësojnë marrjen e 180 pikë krediti.

Në vitin 2010, si reflektim i natyrshëm i rritjes së kapaciteteve akademike dhe në përgjigje të kërkesave në rritje të shëndetit komunitar, departamenti ekzistues i Infermierisë u pasua nga hapja e dy departamenteve të reja: departamentit të Shëndetit publik dhe departamentit të Nënës & Fëmijës.

Me ndryshimin e emrit nga Infermieri në Shëndet Publik krijohen mundësi të reja për zgjerimin sasior dhe cilësor të programeve akademike që do të ofrohen në vazhdimësi, si master e doktoraturë në Shëndet Publik në të cilat do të diplomohen jo vetëm infermierë, por edhe specialistë të shëndetit publik, mjekë, ekonomistë, juristë, etj. Pas riorganizimit në dhjetor 2016, tashmë Fakultetit Shëndetit Publik, Vlorë përbëhet nga dy departamente (Infermieri dhe Kujdes Shëndetësor), si dhe një Qendër Studimore për Shëndetin Komunitare.

Në Nëntor 2011 Fakulteti i Shëndetit Publik (ish Shkolla Mjekësore ‘Jani Minga’) u nderua me çmimin e artë ‘Hyppocrates Order’, dhënë për Kontributin e Çmuar në Zhvillimin e Mjekësisë Shqiptare nga Shoqata Mjekësore Ndërkombëtare Hippokrati me president Dr. Viktor Shehu.

Fakulteti i Shëndetit Publik i UV ‘Ismael Qemali’ aktualisht formon infermierë të përgjithshëm dhe të profilizuar në fusha të ndryshme të shërbimit infermieror dhe të shëndetit publik. Ngritja e këtij fakulteti në shtator 2011, në një stad të ri organizimi dhe funksionimi (nga fakultet infermierie në fakultet të shëndetit publik), krijoi hapësira për zgjerimin cilësor të programeve akademike që do të ofrojë në vazhdimësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

3.2 Logjistika:

Fakulteti i Shëndetit Publik disponon 5 auditore leksionesh, 1 sallë seminaresh, 3 ambiente mësimdhënëse pranë Spitalit Rajonal dhe Spitalit Psikiatrik të Vlorës, 2 laboratore Infermierie, 1 laborator Mami, 2 laboratore Anatomie dhe ambiente për stafin akademik dhe administrativ. Ambientet e mësimdhënies janë të pajisura relativisht sipas standarteve bashkëkohore të mësimdhënies. Ka ende nevojë për plotësimin me pajisje audiovizive dhe për sigurimin e temperaturës neutrale.

Raporti Studentë / Sipërfaqe: $1362.6 : 1062 = 1.3$

Raporti Studentë / Sipërfaqe sipas fashave orare: 1×2 fasha orare = **2.6**

Logjistika në ndihmë të pedagogëve/kërkuesve/stafit administrativ është e plotësuar. Pothuaj çdo anëtar i stafit është pajisur me kompjuterin e tij personal. Në funksion të fakultetit janë vënë pajisje multifunkionale që shërbejnë si printer dhe fotokopje. Gjithashtu njësitë bazë disponojnë edhe videoprojektorë portabël. Shërbimi internet është i vazhdueshëm. Pas miratimit të financimit të Laboratorit klinik-mikrobiologjik, i cili tashmë ka marrë miratimin e financimit nga Bordi Administrativ i UV, ai do të jetë shumë shpejt në funksion të kërkuesve të QSSH.

3.3 Burimet njerëzore:

Personeli akademik i FSHP përbëhet nga 29 pedagogë, 3 personel ndihmës/akademik me karakter mësimor dhe 4 personel ndihmës/akademik me karakter administrativ. Raporti pedagog/studentë është 1 pedagog / 34 studentë (ky raport është brenda normativave të MASR).

Personeli akademik disponon 1 titull: Profesor Doktor, 2 tituj: Profesor i asocijuar, 9 tituj Doktor i Shkencave Mjekësore dhe 4 Kandidatë për Doktor Shkencash. FSHP nuk ka në strukturën e tij asnjë strukturë administrative të pavarur nga Rektorati i UV: as në shërbimet financiare, as në shërbimet e IT apo të mirëmbajtjes.

FSHP mbështetet gjerësisht në bashkëpunimin me Spitalin Rajonal të Vlorës, Spitalin Rajonal të Fierit dhe Spitalin Psikiatrik të Vlorës për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale, si dhe për angazhimin e specialistëve të këtyre spitaleve si pedagogë të jashtëm në module specifike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

3.4 Burimet bazë të financimit:

Burimet e financimi të Fakultetit të Shëndetit Publik janë:

- Granti i mësimdhënies nga Buxheti i Shtetit.
- Të ardhurat dytësore nga tarifat e studimeve dhe shërbimeve që FSHP ofron.
- Të ardhurat dytësore nga shërbimet që FSHP ofron për të tretët (kredite për personelin shëndetësor nëpërmjet aktiviteteve LLL).
- Donacione nga biznesi (Banka Raiffeisen).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

4. ANALIZA SWOT

4.1 Strengths -Pikat e forta

- Cilësi dhe përkushtim në mësimdhënie, ofrimin e shërbimeve dhe këshillim studentor
- Kurrikula të përshtatura me programet europiane/USA, dhe të strukturuar sipas modeleve bashkëkohore, lehtësojnë njohjen e tyre në tregun e huaj të punës.
- Laboratore didaktike me standarte bashkëkohore
- Zhvillimi i praktikës profesionale në një rrjet spitalesh rajonale.
- Literaturë bazë e konsoliduar në dispozicion të studentëve.
- Ofrimi i mësimin të gjuhës së huaj (anglisht/gjermanisht) gjatë gjithë planit mësimor.
- Përdorimi i teknologjisë moderne në procesin e mësimdhënies
- Kapacitete profesionale dhe me eksperiencë në organizimin e aktiviteteve promovionale dhe LLL.
- Dokumentacion rregullator i detajuar për funksionimin e programeve mësimore, departamenteve dhe fakultetit.
- Vlerësim i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët
- Informatizimi i sistemit në funksion të informimit të studentëve
- Bashkëpunim me universitetet brenda dhe jashtë vendit
- Staf akademik me kohë të plotë i kualifikuar dhe në proces kualifikimi.
- Publikim i punimeve shkencore të stafit akademik në revista ndërkombëtare të indeksura.
- Citim i punimeve të stafit nga autorë ndërkombëtar.

4.2 Weaknesses -Pikat e dobëta

- Infrastruktura në dispozicion të stafit dhe studentëve (1 student x 5 m²) është e pamjaftueshme
- Infrastruktura në dispozicion të laboratorëve është e kufizuar
- Mungon thuajse tërësisht biblioteka dhe abonimet online.
- Pjesëmarrje e kufizuar në projekte ndërkombëtare
- Pjesëmarrje e ulët e pedagogëve dhe studentëve në projekte rajonale
- Vështirësi objektive për studime doktorature për stafin infermieror
- Infrastruktura dhe logjistike për kërkim e pamjaftueshme për të qënë konkures në treg.
- Mungesa e binjakëzimeve me qendra të ngjashme me universitete si brenda dhe jashtë vendit.
- Burime të kufizura për shkrim dhe aplikim projektsh si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Burime financiare të pamjaftueshme për mundësi të botimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të stafit në revista ndërkombëtare të indeksura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

- Mungesë e citimit të punimeve shkencore nga stafi akademik si brenda qendrës dhe jashtë saj nga njësitë e tjera bazë të fakultetit.
- Mungesa e kuadrit ligjor për tregun e punës së diploma profesionale, kufizon mundësinë e ofrimit të këtyre të fundit.

4.3 Opportunities–Mundësitë

- Fakulteti i Shëndetit publik ka një strukturë gjithëpërfshirëse në njësitë e tij përbërëse: Departamenti i Infermierisë – fusha e Infermieristikës, Departamenti i Kujdesit Shëndetësor – fusha e Mjekësisë, QSSHP – fusha e Shëndetit Publik. Kjo i krijon mundësi FSHP të operojë në të treja fushat, duke pasur mundësi të ofrojë shumë tipe diplomash, dhe sidomos të zhvillojë punë kërkimore-shkencore të gjithëanëshme (mjekësi, infermieri, shëndet komunitar).
- Diplomat që FSHP ofron kanë shumë hapësira në tregun e huaj të punës.
- Marrveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal të Fierit (modernizimi i të cilit në nivele europiane është në planet afatshkurtra të Qeverisë Shqiptare) krijon një mundësi të artë në rritjen e standartit të zhvillimit të praktikës infermiere: studentët do të kenë mundësi të praktikohen në grupe më të vogla dhe me një numër më të madh pacientësh.
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese të FSHP bën pjesë në prioritetet stragjike të UV (ngritja e një godine të re dhe modernizimi i aredimeve ekzistuese)
- Laboratori biokimik-mikrobiologjik që është buxhetuar, do të ndikojë drejtpërdrejtë në arritjen e një standarti të ri të zhvillimit të kërkimit shkencor, si dhe do të mundësojë ofrimin e programit: Teknik laborator.
- Marrveshja e mobilitetit në staf dhe studentë (Tailin, Estoni) do të mundësojë shkëmbimet akademike në kuadër të projektit Erasmus.
- Mungesa e konkurrentëve në nivel rajonal: jemi praktikisht i vetmi fakultet shëndeti dhe japim diplomat më prestigjioze në Shqipërinë e Jugut.

4.4 Threats –Risqet

- Numri i madh i institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në Infermieri të ngjashme me FSHP. Disa prej tyre (Tirana, Durrësi) ofrojnë mundësi jetese dhe punësimi shumë më të larta se qyteti i Vlorës.
- Largimi i studentëve cilësorë jashtë vendit.
- Niveli i ulët i angazhimit të studentëve në veprimtaritë akademike dhe shërbimet ndaj fakultetit.
- Mosnjohja e gjuhëve të huaja përbën një kërcënim serioz për mobilitetin si të studentëve, ashtu edhe të pedagogëve nga universitete të huaja.
- Burime të kufizuara për të rekrutuar personel akademik me tituj dhe grada shkencore.
- Infrastrukturë e kufizuar në dispozicion të departamentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

- Ndryshimi i qëndrimit dhe opinionit të komunitetit ndaj shërbimeve që qendra ofron në funksion të përmirësimit të shëndetit.
- Promovim i pamjaftueshëm në komunitetin dhe stakeholders lokal i rolit, misionit, dhe shërbimeve të qendrës.
- Infrastrukturë e kufizuar në dispozicion të qendrës për të qënë në koherencë me ndryshimet në stilin e jetesës dhe lëvizjen e lirë të njerëzve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

5. PRIORITETET STRATEGJIKE

Në funksion të përmbushjes të vizionit të FSHP: *Standart akademik ekselent: studentë të formuar profesionalisht për të qenë të gatshëm të integrohen në të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit. Fakulteti i Shëndetit Publik të funksionojë si qendër rajonale e promovimit të rritjes së standarteve të shërbimit shëndetësor në komunitet.*, dhe duke u bazuar në analizën e gjendjes aktuale dhe të nevojave akademike dhe administrative të FSHP, janë identifikuar tre prioritete strategjike të Fakultetit të Shëndetit Publik, të lidhura me parimet bazë të zgjerimit dhe përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga fakulteti ynë.

- Prioritet strategjik 1: Përmirësimi i infrastrukturës akademike, deri në nivelin e standarteve europiane.
- Prioritet strategjik 2: Fuqizimi i sistemit akademik, duke vendosur në qendër studentët.
- Prioritet strategjik 3: Ndërkombëtarizimi i aktivitetit kërkimor-shkencor.
- Prioritet strategjik 4: Rritja e standarteve të shërbimeve komunitare, aktiviteteve LLL dhe promovimit shëndetësor.

5.1 Objektivat strategjikë të zhvillimit të Fakultetit të Shëndetit Publik

Prioritet strategjik 1: Përmirësimi i infrastrukturës akademike, deri në nivelin e standarteve europiane.

Rezultati i pritshëm: Rritja e cilësisë së infrastrukturës dhe teknologjisë së mësimdhënies, nëpërmjet investimeve të qëndrueshme.

Objektivi 1.1: Modernizimi i auditorëve mësimorë dhe laboratorëve të Infermieririsë, Mamisë dhe Anatomisë sipas standarteve europiane.

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 3: Shëndet dhe Mirëqënie

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 9: Infrastrukturë rezistuese

OZHQ 10: Reduktimi i pabarazive

OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

OZHQ 17: Forcimi i partneritetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

Objektivi 1.2: Ngritja e laboratorëve të rinj (klinik, fizioterapeutik, qendres per Infermieri ne Familje).

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 3: Shëndet dhe Mirëqënie

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 9: Infrastrukturë rezistuese

OZHQ 10: Reduktimi i pabarazive

OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

OZHQ 17: Forcimi i partneritetit

Prioritet strategjik 2: Fuqizimi i sistemit akademik, duke vendosur në qendër studentët.

Rezultati i pritshëm: Përmirësimi i cilësisë dhe i shërbimeve akademike, bazuar në financimin e qëndrueshëm, zhvillimin e infrastrukturës mësimore, fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Objektivi 2.1: Zgjerimi i gamës së programeve mësimore të ofruara nga FSHP (nga Diplomat Profesionale në programe të Ciklit të Tretë të Studimeve: specializime dhe doktoratura të përbashkëta me Universitetet Partnere).

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 9: Infrastrukturë rezistuese

OZHQ 10: Reduktimi i pabarazive

OZHQ 17: Forcimi i partneritetit

Objektivi 2.2: Rritja e mobiliteteve akademike dhe studentore me Universitete Europiane.

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 9: Infrastrukturë rezistuese

OZHQ 10: Reduktimi i pabarazive

OZHQ 17: Forcimi i partneritetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

Objektivi 2.3: Përmirësimi i shërbimeve në të gjitha nivelet: sekretari mësimore, këshillim akademik, proces apelimi, nëpërmjet funksionimit të rregullave dhe procedurave të qarta të programeve mësimore / departamenteve / fakultetit.

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 9: Infrastrukturë rezistuese

OZHQ 10: Reduktimi i pabarazive

OZHQ 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

OZHQ 17: Forcimi i partneritetit

Objektivi 2.4: Forcimit i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë.

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 9: Infrastrukturë rezistuese

OZHQ 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

Prioritet strategjik 3: Ndërkombëtarizimi i aktivitetit kërkimor-shkencor.

Rezultati i pritshëm: Njohja ndërkombëtare e studimeve të stafit akademik të FSHP, nëpërmjet angazhimit në projekte ndërkombëtare dhe publikimeve në periodikë prestigjiozë.

Objektivi 3.1: Rritja e standarteve të kërkimeve shkencore (në studime analitike, eksperimentale), me fokus studimet epidemiologjike në komunitet

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 3: Shëndet dhe Mirëqënie

OZHQ 1: Jo varfërisë

OZHQ 2: Jo urisë

OZHQ 6: Ujë i pastër dhe Sanitet

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

OZHQ 13: Veprim për klimën

OZHQ 16: Paqe dhe drejtësi

OZHQ 17: Forcimi i partneritetit

-

-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

Objektivi 3.2: Orientimi i kërkimit shkencor të FSHP ndaj nevojave të identifikuara në shërbimit shëndetësor dhe Rritja e ndërgjegjësimit të strukturave shëndetësore për praktikimin e shërbimit shëndetësor të bazuar në evidenca dhe implementimin e rekomandimeve të kërkimit shkencor të aplikuar.

Lidhja me OZHQ:

- OZHQ 3: Shëndet dhe Mirëqënie
- OZHQ 1: Jo varfërisë
- OZHQ 2: Jo urisë
- OZHQ 4: Edukim cilësor
- OZHQ 6: Ujë i pastër dhe Sanitet
- OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike
- OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme
- OZHQ 13: Veprim për klimën
- OZHQ 16: Paqe dhe drejtësi
- OZHQ 17: Forcimi i partneritetit

Prioritet strategjik 4: Rritja e standarteve të shërbimeve komunitare, aktiviteteve LLL dhe promovimit shëndetësor.

Rezultati i pritshëm: Fakulteti i Shëndetit Publik të funksionojë si qendër rajonale e promovimit të rritjes së standarteve të shërbimit shëndetësor në komunitet.

Objektivi 4.1: Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetës dhe mundësimi i zgjedhjeve të shëndetshme.

Lidhja me OZHQ:

- OZHQ 3: Shëndet dhe Mirëqënie
- OZHQ 1: Jo varfërisë
- OZHQ 2: Jo urisë
- OZHQ 4: Edukim cilësor
- OZHQ 6: Ujë i pastër dhe Sanitet
- OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike
- OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme
- OZHQ 13: Veprim për klimën
- OZHQ 16: Paqe dhe drejtësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

Objektivi 4.2: Zhvillim dhe propagandim i dokumentave praktike, standarteve dhe mjeteve menaxhuese për implementimin e vazhdueshëm të kërkimit në praktikën klinike të kujdesit shëndetësor.

Lidhja me OZHQ:

OZHQ 3: Shëndet dhe Mirëqënie

OZHQ 1: Jo varfërisë

OZHQ 2: Jo urisë

OZHQ 4: Edukim cilësor

OZHQ 6: Ujë i pastër dhe Sanitet

OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

OZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

OZHQ 13: Veprim për klimën

OZHQ 16: Paqe dhe drejtësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

6. PLANI I VEPRIMIT, NË PËRMBUSHJE TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK

Hapat që do ndërmerren	Personat përgjegjës	Komunikimi	Burimet	Afati	Pengesa/rreziqe të mundshme
Mësimdhënia cilësore					
Mësimdhënia cilësore <ul style="list-style-type: none">Identifikimi i nevojave dhe problematikave të departamentit.Sigurimi i instrumentave financiare për përmirësimin e mësimdhëniesSigurimi i instrumentave jo vetëm Institucionalë por edhe projekte të ndryshme në nivel ndërkombetar të financuar nga KE.Realizmi i Aktiviteteve trajnuese për stafin pedagogjik prej pedagogëve të njohur Shqiptarë dhe të huaj.Dhënia prioritet në marrëveshjet e bashkëpunimit, mobilitetetit të stafit për mësimdhënie.Hartimi dhe shqyrtimi i strategjive pedagogjike.Hapja e programeve të reja të studimit.Aplikimi i Departamenteve në thirrje të ndryshme të BE për hapjen e programeve të doktoraturës dhe bashkëpunimi me institucionet brenda vendit.Zhvillimi i lëndëve në përputhje me formimin dhe profilin specifik të pedagogëve.Punësimi i stafit të ri akademik, cilësor dhe premtues.	Rektorati Dekanati Drejtuesi i QSSHP Drejtuesit e Departamenteve Stafi akademik i njësive bazë	Njësia Kryesore Njesia Baze Rektorati Mjete zyrtare dhe jo zyrtare komunikimi per te arritur lidhjen e marrëveshjeve	Burimet financiare te UV Rektorati Njësia Kryesore Njësia Bazë Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë Sektori i promovimit akademik dhe botimeve shkencore Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional	Çdo vit Gjatë gjithë vitit	Mungesë bashkëpunimi. Mungesë financimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

<ul style="list-style-type: none">• Krijimi i instrumentave të nevojshëm për të vlerësuar dhe matur performancën si në nivel cilësor edhe sasior.• Marrja e masave disiplinore ndaj pedagogëve të cilët për më shumë se dy vjet marrin referime negative prej studentëve.			Departamenti i Edukimit		
Infrastrukturë optimale					
Infrastrukturë optimale fizike <ul style="list-style-type: none">• Ngritje e godinës së re të FSHP• Krijimi i laboratorëve të rinj dhe pasurimi i atyre ekzistues.• Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe mbështetëse për studentët dhe pedagogët krijimin e lehtësirave për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi.	Rektorati Dekanati Drejtuesit e Njësive Bazë		Drejtoria e Edukimit Cikli I&II(SBSH) Sektori i teknologjisë së zhvillimit IT Njësia Kryesore Administratori Bordi i Administrimit	2018 - Në vazhdim	Mungesë financimi.
Kërkimi shkencor					
Kërkim shkencor cilësor <ul style="list-style-type: none">• Përmbyllje e kërkesave ligjore për botime dhe konferenca• Botime dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në vendet e BE• Krijimi i bazës formale dhe informale të të dhënave, që çdo ndryshim protokollit në menaxhimin e shërbimeve shëndetësore të argumentohet nëpërmjet studimeve të fizibilitetit apo eksperimentale (të bazohet në evidenca shkencore).• Me zhvillimet shumë të shpejta dhe fuqinë e madhe që ka teknologjia në komunikim, është e nevojshme krijimi i një database të kërkimit shkencor me akses për të gjithë stafin akademik, studentët dhe komunitetin e operatorëve shëndetësor.	Stafi akademik i QSSHP dhe Departamenteve		Burimet financiare të UV	Çdo vit	Mospërmbyllje e detyrimit nga i gjithë stafi. Publikime në revista jo të indeksuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

<ul style="list-style-type: none"> • Botimi i një raporti për të gjitha punimet e kryera në fushën e shëndetit (të botuara apo jo) nga stafi akademik i fakultetit, studentët dhe profesionistët shëndetësor, praktikues në praktikën klinike, që kanë qenë pjesë e fakultetit dhe tashmë janë pjesë e institucioneve shëndetësore lokale. Fillimi i projektit në 2018. Synohet bashkëpunimi dhe me partnerët lokal si dhe kërkimi i burimit të financimit dhe nga organizata të tjera fitim dhe jo fitimprurëse. Indikator i suksesit – botimi i raportit. • Në periudhën kohore të strategjisë synohet krijimi i një baze të dhënash me mundësi diseminimi për të gjitha projektet e kryera nga FSHP dhe sa prej tyre janë implementuar. 					
<p>Shërbimet ndaj të tretëve</p>					
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i cilësisë së rezultateve në shëndet, në komunitetin lokal dhe global nëpërmjet përdorimit dhe diseminimit të rezultateve të kërkimit në aktivitetet promovuese. • Shërbimi për promovim të shëndetit dhe mirëqënies në nivel lokal, kombëtar dhe global. • Rritja e numrit të shërbimeve që ofrohen për komunitetin. Zgjatja e kohës së ofrimit të këtyre shërbimeve. • Krijimi i një portali on-line për promocionin shëndetësor me informacione të përditësuara. • Zhvillimi i trajnimeve në komunitet për masterizimin e pacientëve kronikë apo familjarëve të tyre. • Përdorimi i aktivitetet promovionale dhe shërbimit komunitar për mbledhjen e të dhënave për kërkime shkencore. • Ofrimi i aktivitetet të edukimit në vazhdim me dhe pa kredite 	<p>Rektorati Drejtuesi i QSSHP Drejtuesit e Departamenteve Stafi akademik i njësisive bazë</p>	<p>Mjete zyrtare dhe jo zyrtare komunikimi për të arritur lidhjen e marrëveshjeve. Leksione dhe kurrikula të ndryshuara.</p>	<p>Burime financiare të UV dhe financime nga të tretët Burime financimi nga UV</p>	<p>Çdo vit 2018-vazhdim</p>	<p>Mungesë bashkëpunimi Mungesë interesi nga stafi akademik</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI**

<p>për profesionistët e kujdesit shëndetësor.</p> <ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i aktiviteteve në komunitet me fokus promovimin e shëndetit bazuar në rezultatet e studimeve screening të realizuara nga Qendra në aktivitete të mëparshme të ngjashme 					
Mbështetje më e madhe për studentët.					
<ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e studentëve në aktivitete shkencore si konferenca, seminare, publikime, konkurse etj. Përfshirja e studentëve në projekte të shkëmbimit të eksperiencës. Nxitja e studentëve për përfshirje në aktivitete sociale dhe kulturore. Zhvillimi i marrëdhënies student-pedagog duke krijuar një raport bashkëpunimi në përmirësimin e kurikulave dhe kërkimit shkencor. 	<p>Stafi akademik. Studentët</p>	<p>Komunikimi përmes faqes zyrtare dhe emailit.</p>	<p>Burime financiare të UV dhe financime nga të tretë.</p>	<p>Cdo vit</p>	<p>Mungesë interesi dhe/ose mungesë bashkëpunimi</p>
Ndërkombëtarizimi					
<ul style="list-style-type: none"> I programeve duke synuar programe te perbashketa me Universitete perëndimore. I kurrikulave përmes ndryshimit të kurrikulave në përfaqje me ato të vendeve evropiane. I stafit dhe studentëve duke marrë pjesë në programet e shkëmbimit të stafit dhe studentëve. I bashkëpunimit duke nxitur stafin të bëjë pjesë në rrjete ndërkombëtare kërkuesish dhe duke rritur imazhin e departamentit jo vetëm brenda vendit por edhe më gjerë. 	<p>Rektorati Dekanati Stafi akademik Partnerë Studentët</p>	<p>Mjetet zyrtare të komunikimit. Komunikim me rrjetet e kërkimit shkencor. Kontakte nga vetë stafi akademik.</p>	<p>Burime financiare të UV dhe financime nga të tretë.</p>	<p>2018 e në vazhdim</p>	<p>Vështirësi në krijimin e partneritetit. Mungesë interesi nga stafi apo studentët</p>
Cilësia e stafit mësimdhënës.					



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

<ul style="list-style-type: none"> Nisja e shkollës së Doktoratës nga stafi me titull MSc. Përfundimi i procesit të Doktoraturës për stafin që është në vazhdim. Nisja e procedurës për marrjen e titullit shkencor Prof.Asoc. 	Stafi i Departamentit	Pedagogët në proces të marrjes së titullit doktor shkencash ose Prof.Asoc	Literaturë hard copy, elektronike dhe online Biblioteka online	2018 e në vazhdim	Angazhimi i stafit me aktivitete të tjera mësimdhënëse dhe kërkimore.
Programet mësimore					
Sistemi Bachelor 3 vjeçar <ul style="list-style-type: none"> Do të ndryshohen programet mesimore duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi. 	Stafi akademik i Departamentit. Drejtuesi i Njesisë Bazë.	Përgjegjësi i grupit mësimor. Drejtuesi i Njesisë Bazë.	Programe mësimore të ngjashme të universiteteve brenda dhe jashtë vendit.	Viti akademik 2018-2019	Elementi kohë. Vonesa për miratimin e ndryshimeve të propozuara.
Masteri shkencor <ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i programit të lëndëve mësimore. 	Drejtuesi i Njesisë Bazë. Stafi akademik i departamentit	Drejtuesi i Njesisë Bazë.	Programe mësimore të ngjashme të universiteteve brenda dhe jashtë vendit.	Viti akademik 2018-2019	Elementi kohë. Vonesa për miratimin e ndryshimeve të propozuara.
Masteri profesional <ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i programit të lëndëve mësimore. 	Drejtuesi i Njesisë Bazë. Stafi akademik i departamentit	Drejtuesi i Njesisë Bazë.	Programe mësimore të ngjashme të universiteteve brenda dhe jashtë vendit.	Viti akademik 2018-2019	Elementi kohë. Vonesa për miratimin e ndryshimeve të propozuara.
Studentët					
Shërbim funksional dhe efektiv për studentin: <ul style="list-style-type: none"> Masa për të krijuar të gjitha facilitetet e mundshme për 	Stafi akademik Kordinatorët për	Drejtuesi i Njesisë Bazë.	Burime financiare të UV.	Çdo vit	Mungesë bashkëpunimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

<p>studentët, nga momenti i përfitimit të këtij statusi e deri në përfundim të tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vënia në dispozicion të studentëve të broshurave mbi programet e studimit, si dhe mbi aktivitetet e institucionit. • Rritja e mbikqyrjes së asistentëve kërkimor në kryerjen e hulumtimit. • Shtim dhe përmirësim i hapësirave fizike dhe pajisjeve për mësimdhënie bashkëkohore e cilësore. <p>Pjesëmarrja në vendimmarrje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Masat për të stimuluar dhe promovuar të drejtën e vetorganizimit të studentëve duke u dhënë atyre një rol të rëndësishëm në vendimmarrje. • Funksionimi i këshillit studentor në fakultet. 	<p>marrëdhëniet me studentët</p> <p>Sekretaritë mësimore</p> <p>Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë</p> <p>Spektori i Këshillimit të Studentëve</p>				Mungesë financimi.
Bashkëpunimi me partnerët e tregut të punës:					
<ul style="list-style-type: none"> • Aftësim profesional i studentëve. • Zhvillimi i praktikave profesionale. • Përgatitje të specialistëve, që t'u përgjigjen nevojave të tregut të punës. • Partneritet me komunitetin për të harmonizuar dijen me profesionin dhe zhvillimin lokal dhe rajonal. 	<p>Rektorati</p> <p>Dekanati</p> <p>Drejtuesit e Departamenteve</p> <p>Stafi akademik i njësive bazë</p>	<p>Komunikimi përmes postës elektronike dhe mjeteve të tjera zyrtare të komunikimit, postës, telefonit.</p>	<p>Burime financiare të UV.</p>	<p>Çdo vit</p>	<p>Mungesë bashkëpunimi dhe interesimi nga të dyja palët.</p>
Impakti i fakultetit:					
<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i departamenteve tek studentët potenciale, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Drejtoritë Arsimore Rajonale. 	<p>Drejtuesi i Njesisë Bazë</p>	<p>Komunikimi përmes postës</p>	<p>Burime financiare dhe njerëzore.</p>	<p>Çdo vit</p>	<p>Mungesa e burimeve të</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

<ul style="list-style-type: none">• Aplikimi i politikës gjithpërfshirëse të mirëpritjes së studentëve të rinj nga gjithë Shqipëria dhe studentëve të huaj me anë të marrëveshjeve ndër-institucionale.• Promovimi i politikave të afrimit me alumnit, duke krijuar mundësi të shumta kontakti me ta.• Mbajtja e të dhënave të të punësuarve të ish- studentëve në këtë institucion.• Promovimi i departamenteve në aktivitete të tjera profesionale dhe kualifikuese.• Përdorimi i mjeteve promocionale me logo të fakultetit/UV.• Përfshirje në skema financimi për projekte zhvillimi dhe kërkimi.	Stafi akademik	elektronike dhe mjeteve të tjera zyrtare të komunikimit, postës, faksit, telefonit.			mjaftueshme financiare.
--	----------------	---	--	--	-------------------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

7. INDIKATORËT E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË STRATEGJISË

Vlerësimi i suksesit të punës së FSHP nëpërmjet vlerësimit të impaktit të mësimdhënies / kërkimit do të matet nëpërmjet indikatorëve të performancës si më poshtë:

Indikatorët e Performancës	Targeti - Objektivi
Infrastruktura	
Godina e re për FSHP	100%
Ngritja e Laboratorit klinik	100%
Ngritja e Qendrës Trajnuese Simulatore	100%
Pasurimi i laboratoreve ekzistuese	↗
Paisja e gjithë auditoreve me paisje audio-vizive	100%
Biblioteka on-line	100%
Stafi	
% e stafit me gradën Dr.	100%
% e stafit që do të përfshihet në programe mobiliteti	↗
Studentët	
% e studentëve që do të përfshihen në programet e mobilitetit	↗
Kalueshmëria dhe Cilësia në provimin e liçencës	↗
% e studentëve që do të punësohen brenda vitit të parë të diplomimit	↗
% e studentëve pjesëmarrës në studime/veprimtari shkencore dhe në programin e Masterit Shkencor	↗
Aktivitetet LLL	
% e konferencave, simpoziumeve	↗
% e aktiviteteve promovionale	↗
Publikimet	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEKANI

Sasia e publikimeve	↗
Publikime të indeksuara	↗
Publikime të indeksura në bashkëpunim me universitete të tjera jashtë vendit	↗
Citimi i publikimeve	↗
Financimi	
Numri i botimeve të rimbursuara nga UV	↗
Projekte të fitura	↗
Financime nga donatorë vendas dhe të huaj	↗